



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 08.11.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “TELEKOM ALBANIA”,
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 3 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA:
“KRUJA EAST 1627”, “POGRADECI WEST 1633” DHE “BC HOTEL NEW 1643”, ME
VENDNDODHJE BASHKITË KRUIË, POGRADEC DHE TROPOJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit “Telekom Albania”, nëpërmjet shtimit të antenave për 3 stacione bazë të emërtuara: “Kruja East 1627”, “Pogradeci West 1633” dhe “BC Hotel New 1643”, me vendndodhje bashkite Krujë, Pogradec dhe Tropojë”, me zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 3 stacioneve bazë, vetëm pas:
 - a. Për stacionin “**Kruja East 1627**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Krujë.
 - b. Për stacionin “**Pogradeci West 1633**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Pogradec.
 - c. Për stacionin “**BC Hotel New 1643**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tropojë.



4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

